



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 08/L - 019

**PËR AMENDAMENTIMIN 02 TË MARRËVESHJES BILATERALE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE
QEVERISË SË DUKATËS SË MADHE TË LUKSEMBURGUT PËR
PROJEKTIN E BASHKËPUNIMIT PËR ZHVILLIM “KSV/017:
PROGRAMI PËR MBËSHTETJE SHËNDETËSORE (PJESA II)”**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR AMENDAMENTIMIN 02 TË MARRËVESHJES
BILATERALE NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS DHE QEVERISË SË DUKATËS SË MADHE TË
LUKSEMBURGUT PËR PROJEKTIN E BASHKËPUNIMIT PËR
ZHVILLIM “KSV/017: PROGRAMI PËR MBËSHTETJE
SHËNDETËSORE (PJESA II)”**

Neni 1
Qëllimi

Me qëllim të përmbushjes së procedurave ligjore të parapara me nenin 4, paragrafin 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, ky Ligj amendanton Marrëveshjen ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut për Projektin e Bashkëpunimit për Zhvillim “KSV/017: Programi për Mbështetje Shëndetësore (Pjesa II)”.

Neni 2

Ratifikimi i amendamentimit 02 të Marrëveshjes Bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut për Projektin e Bashkëpunimit për Zhvillim “KSV/017: Programi për Mbështetje Shëndetësore (Pjesa II)”

Ratifikohet amendamenti 02 i Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut për “Projektin e Bashkëpunimit për Zhvillim-KSV/017: Programi për Mbështetje Shëndetësore (Pjesa II)”.

Neni 3

Obligimet Republikës së Kosovës

1. Pas Ratifikimit nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës të Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut për “Projektin e Bashkëpunimit për Zhvillim-KSV/017: Programi për Mbështetje Shëndetësore (Pjesa II)”, obligohet Qeveria e Republikës së Kosovës t'i kryejë të gjitha obligimet të cilat dalin nga marrëveshja e ratifikuar.

2. Obligohet Qeveria e Republikës së Kosovës t'i përmbushë të gjitha kushtet dhe obligimet duke përfshirë edhe ato financiare të cilat dalin nga marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut për “Projektin e Bashkëpunimit për Zhvillim-KSV/017: Programi për Mbështetje Shëndetësore (Pjesa II)”.

Neni 4

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 08/L-019
6 gusht 2021

Glauk KONJUFCA

Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës